



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr.10

Prishtinë, më 04.12.2017, në orën:10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Jasmina Zhivković, Valon Ramadani, Fisnik Ismaili, Imet Rrahmani, Xhevahire Izmaili, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Mungoi: Arban Abrashi.

Në mbledhje morën pjesë: OSBE, KDI, Swor- Kosovo, Koha ditore, Kosovapress dhe RTK-Radio.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.11.2017;
3. Diskutim lidhur me Draft-ligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
4. Diskutim lidhur me ecurinë e punës së Komisionit për amendamentimin e Projektligjit nr.06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime, me një pikë shtesë: Çështja e bordeve të emëruara nga Kuvendi dhe Qeveria

2. Miratimi i procesverbalit, të mbledhjes së mbajtur më 20.11.2017,
u miratuan pa vërejtje.

3. Çështja e bordeve të emëruara nga Kuvendi dhe Qeveria

Për këtë pikë të rendit të ditës, komisioni ka kërkuar nga administrata e Kuvendit, të përgatitë listën e të gjitha bordeve dhe agjencive të emëruara nga Kuvendi dhe Qeveria dhe të kërkohet nga Agjencia Kundër Korrupsion dhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të verifikojnë për të gjitha bordet dhe agjencitë e emëruara nga Kuvendi dhe Qeveria, se a kanë konflikt interes në ushtrimin e funksionit publik?

4. Diskutim lidhur me Draft-ligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Komisioni diskutoi për draft-ligjin dhe me disa ndryshime të inkuorporuar, vendosi unanimitisht që drafti të procedohet në Qeveri për mendim, konform Rregullores së Kuvendit.

5. Diskutim lidhur me ecurinë e punës së Komisionit për amendamentimin e Projektligjit nr.06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën

Për këtë pikë të rendit të ditës, kryetari i komisionit propozoi, që para fillimit të amendamentimit, për arsye të rëndësishme që ka P/ligji për Prishtinën, të mbahet dëgjim publik.

Gjithashtu, Komisioni mori vendim që të bëhet një vizitë në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Maqedonisë, lidhur me P/ligjin për Prishtinën.

Lidhur me këto propozime, komisioni vendosi unanimitisht dhe caktoi listën e të ftuarve për dëgjim publik, datën dhe kohën e mbajtjes së dëgjimit publik si dhe për datat për vizitat e lartpërmendura.

Mbledhja përfundoi në orën:11:15.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Nait Hasani